

VENDIM
Nr. 491, datë 31.7.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR PAGESËN E
SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË GJYKATAT
ITALIANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në kategorinë e shpenzimeve korrente, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) eurosh, për kryerjen e pagesave të shërbimeve juridike nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të këtij institucioni kundër bllokimit të garancive të kontratave për bypass-et e Vlorës e të Fierit në gjykatat italiane, nga shoqëritë “Serenissima Costruzioni s.p.a.” dhe “A4 Holding s.p.a.”.

2. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Autorizohet Autoriteti Rrugor Shqiptar të lidhë kontratë me studion avokatore italiane, e cila ka kryer përfaqësimin, deri në këtë moment, të Republikës së Shqipërisë në gjykatat italiane, të negociuar nga Avokatura e Shtetit, me vlerë të përgjithshme 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) euro.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama